



Duke u mbështetur nën nenin 40 paragrafi 40.2 nën c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenit 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës me kërkesën e Drejtorisë së Financave, Ekonomi dhe Zhvillim të datës 22.07.2021 me nr.01-400-23640, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e VII-të të rregullt për vitin 2021, të mbajtur me datën 30.07.2021 mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ri-alokim të mjeteve, në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale fondi burimor 10.
2. Në kuadër të programit Shëndetësi dhe mirëqenie sociale (730), nga nen-programi Shërbimet e shëndetësisë primare (74050), kodi funksional (0721) nga Projekti “Blerja e një ambulance mjekësore”, kodi i projektit 50675 shuma 14,200.00 € të ri-alokohen në Projektin “Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore”, kodi i projektit 49621
3. Mjetet si në pikën dy të këtij vendimi ri-alokohen me arsyetimin se pas përfundimit të procedurave të prokurimit për Projektin “Blerja e një ambulance mjekësore”, kodi i projektit 50675, oferta e përgjegjshme me çmimin me të ultë ka qenë në vlerë prej 75,800.00 € dhe si e tillë është ekzekutuar dhe janë përfunduar pagesat me ç ‘rast kanë tepruar mjete në vlerë prej 14,200.00 € të cilat do të ri-alokohen në Projektin “Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore”, kodi i projektit 49621 ku sipas paramasave preliminare vlera e punimeve që planifikohet të realizohen e tejkalon vlerën e planifikuar të buxhetit për këtë projekt.
4. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës konform Rregullores të QRK Nr.10/2019 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Njoftohen:

- MPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtorja për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-25327 /21
Klinë, me 03.07 /21



Kryesuesi,
Fadil GASHI